



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.22

Prishtinë, më 24.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Mungoi: Srdjan Popović

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Bekim Kodraliu-OSBE, Petrit Hysaj-OSBE, Alban Bajrami-RTK Radio, Ukë Gashi-ZPRK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 22.07.2015.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.07.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.07.2015 u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore

Nait Hasani, tha se në këtë mbledhje do të vazhdojmë ta shqyrtojmë Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore nga neni 14, pasi që deri tek neni 13 e kemi amendamentuar në mbledhjen paraprake. Komisioni vazhdoj me shqyrtimin e amendamenteve si vijon:

Amendamenti 14

Neni 14 riformulohet si vijon :

Neni 14

Paraqitja e provimit të maturës

1. Kandidati paraqet provimin e maturës shtetërore më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së provimit. 2. Fletëparaqitja për provimin e maturës shtetërore plotësohet në formularin që merret në shkollë, i cili përmban të dhënat për kandidatin. 3. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidati paraqet edhe: 3.1. Dëftesat për kryerjen e klasave të shkollës së mesme të lartë, 3.2. Certifikatën nga libri amë i të lindurve, 3.3. Diplomën e shkollës së mesme të lartë profesionale. 3.4. Kandidatet/nxënësit që përfundojnë shkollën e mesme të lartë profesionale pajisen me diplomë.

Amendamenti 16

Neni 15 riformulohet si vijon :

Neni 15

Përmbajtja e provimit të maturës

1. Provimi i maturës shtetërore përbëhet nga: 1.1. Lëndët obligative : gjuhë amtare, matematikë dhe gjuhë e huaj. 1.2. Lëndët zgjedhore të propozuara nga DVSM dhe të miratuara nga KSHM. 1.3. Kandidati përcaktohet për lëndet zgjedhore sipas afateve të parapara nga KSHM. 2. Digjitalizimi i provimit të maturës shtetërore rregullohet me akt nënligjor.

Amendamenti 17

Neni 16 riformulohet si vijon :

Neni 16

Kriteret e provimit të maturës

1. Të gjithë nxënësit/kandidatët e gjimnazeve të cilët me sukses e kanë përfunduar vitin e fundit pajisen me diplome dhe i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore. 2. Të gjithë nxënësit/kandidatët që kanë kryer me sukses provimin përfundimtar të arsimit profesional pajisen me diplome. Ata që dëshirojnë regjistrimin në IAL i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore. 3. Pragu i kalueshmërisë në provimin e maturës shtetërore është 45%. 4. Të gjithë kandidatët që kanë kaluar provimin e maturës shtetërore pajisen me certifikate nga KSHM. 5. Kandidatët e pakënaqur me rezultatet e arritura në provimin e maturës shtetërore, kanë të drejtë ta refuzojnë rezultatin me shkrim para marrjes së diplomës dhe t'i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore në afatet vijuese.

Amendamenti 18

Neni 17 riformulohet si vijon :

Neni 17

Obligimet e institucioneve të arsimit të lartë

1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, janë të obliguara që t'i pranojnë rezultatet e arritura të kandidatëve gjatë viteve të shkollimit të mesëm të lartë dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore. 2. Pranimi i studentëve do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura: 2.1. 30% gjatë shkollimit të mesëm të lartë. 2.2. 30% në provimin e maturës shtetërore. 2.3. 40% në vlerësimin e brendshëm të njësive akademike.

Amendamenti 19

Ne nenin 18 nënparagrafi 2.3 riformulohet si vijon :

2.3. Te këtë materiale informuese dhe udhëzuese për mbarëvajtjen e provimit.

Amendamenti 20

Neni 19 riformulohet si vijon :

Neni 19

Vërtetimi i identitetit të kandidatëve

1. Vërtetimi i identitetit të kandidatëve gjatë hyrjes në provimin e maturës, bëhet përmes dokumenteve zyrtare të identifikimit apo nga dokumentet e lëshuara nga institucionet. 2. Nuk lejohet hyrja në provim e kandidatëve që nuk posedojnë një dokument identifikues.

Amendamenti 21

Neni 20 riformulohet si vijon :

Neni 20

Kohëzgjatja e provimit

Kohëzgjatja e provimit caktohet në bazë të numrit të pyetjeve dhe formatit të testit me vendim të KSHM. Vazhdojmë në mbledhjen e radhës tutje Neni 21 Publikimi i rezultateve të provimit DVSM është e obliguar që pas nxjerrjes së rezultateve të provimit të maturës t'ia paraqes KSHM-së për miratim dhe publikim.

Komisioni, në mbledhjen e radhës do të vazhdoj ta shqyrtoj Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore nga neni 21.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani